



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

VENDIM

NR. 9, DATË 29.01.2020

**MBI NDRYSHIMIN E TË DHËNAVE NË STRUKTURËN E PRONËSISË SË
SHOQËRISË "DIGIT-ALB" SH.A.**

Autoriteti i Mediave Audiovizive, i përbërë nga:

Gentian	Sala	Kryetar
Sami	Nezaj	Zëvendëskryetar
Agron	Gjekmarkaj	Anëtar
Gledis	Gjipali	Anëtar
Suela	Musta	Anëtar

mori në shqyrtim çështjen që i përket palëve:

Kërkues: Aksionarë të shoqërisë "Digit-Alb" sh.a.,

Objekt: Njoftim mbi ndryshimin e strukturës së pronësisë së shoqërisë "Digit-Alb" sh.a.

Baza Ligjore: Neni 19, pika 16 dhe neni 74 i ligjit nr. 97/2013, "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar,

VËREN SE:

Shoqëria "Digit-Alb" sh.a., është licencuar për transmetime private numerike kombëtare audiovizive dhe është e pajisur me licencën nr. 001/TPNKA, me afat vlefshmërie deri në datën 04.04.2031.

Po ashtu, shoqëria "Digit-Alb" sh.a., është licencuar me vendimin nr. 785, datë 25.02.2009, të Këshillit Kombëtar të Radios dhe Televizionit (sot Autoriteti i Mediave Audiovizive), si platformë private numerike satelitore. Me vendimin nr. 52, datë 29.03.2019, AMA ka vendosur rinovimin e autorizimit për ofrimin e shërbimit të programit audioviziv dhe për përsëritjen e shërbimit të programit.

Me vendimin nr. 98 prot., datë 19.05.2016, AMA ka autorizuar shoqërinë "DIGIT-ALB" sh.a., për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve, mbështetur në internet (OTT). Afati i vlefshmërisë së autorizimit përfundon në datën 19.05.2021.

AMA, me vendimin nr. 53, datë 29.03.2019 ka vendosur miratimin e ndryshimeve në strukturën e pronësisë së shoqërisë "DIGIT-ALB" sh.a., duke kaluar 0.5% të aksioneve të Eduard Poda, tek aksionari, shoqëria "DEM Capital" sh.p.k., dhe 0.5% të aksioneve të Eduard Poda tek aksionari, shoqëria "E&E INVESTMENT" sh.p.k.

Struktura e pronësisë së shoqërisë e miratuar nga AMA, përbëhet nga aksionarët e mëposhtëm: Alban Jaho, me 3% të aksioneve; Itan Hoxha, me 10.19% të aksioneve; Eduard Poda, me 2% të aksioneve; Enkelejd Joti, me 3% të aksioneve; Redia Hoxha, me 10.19% të aksioneve; Shoqëria "Union Distribucion Servis Albania" sh.p.k., me 10% të aksioneve, Shoqëria "DEM Capital" sh.p.k., me 10.5% të aksioneve; Shoqëria "E&E INVESTMENT" sh.p.k., me 10.5% të aksioneve; shoqëria "UNION GRUP" sh.p.k., me 10% të aksioneve; Shoqëria "LORESA" sh.p.k., me 30,60% të aksioneve.

Me shkresat nr. 192 prot., të datës 22.01.2020 dhe nr. 193 prot., datë 22.01.2020, të depozituara pranë AMA-s, znj. Alba Gina, shoqëria "A.I.B.A. Kompani" sh.a., z. Agim Zeqo dhe z. Samir Mane, në cilësinë e aksionarëve të rinj të shoqërisë "Digit-Alb" sh.a., kanë njoftuar mbi ndryshimet e ndodhura në strukturën e pronësisë së shoqërisë, për shkak të hyrjes së tyre si aksionarë në këtë subjekt.

Njoftimet e mësipërme janë shoqëruar me kopje të ekstraktit për të dhënat e subjektit lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB) në mënyrë elektronike, nga i cili rezulton se struktura e pronësisë është:

- Agim Zeqo me 1.32% të aksioneve;
- Alban Jaho, me 3% të aksioneve;
- Itan Hoxha, me 10.19% të aksioneve;
- Samir Mane, me 1.32 % të aksioneve
- Alba Gina, me 10.3% të aksioneve
- Enkelejd Joti, me 2.52 % të aksioneve;
- Eduard Poda, me 1,52 % të aksioneve;
- Redia Hoxha, me 10.19% të aksioneve;
- Shoqëria "Union Distribucion Servis Albania" sh.p.k., me 6,8 % të aksioneve,
- Shoqëria "DEM Capital" sh.p.k., me 8,90% të aksioneve;
- Arch Investor me 3,20% të aksioneve;
- A.I.B.A. kompani sh.a., me 3,68 % të aksioneve;
- Shoqëria "E&E INVESTMENT" sh.p.k., me 8,90 % të aksioneve;
- Shoqëria "UNION GRUP" sh.p.k., me 6,80 % të aksioneve;
- Shoqëria "LORESA" sh.p.k., 30,60% të aksioneve.

Referuar dokumentacionit të publikuar në faqen zyrtare të QKB-së, rezulton se në datën 31 dhjetor 2019, janë pasqyruar ndryshime në strukturë, ndryshime që kanë ndodhur për shkak të depozitimit të deklaratave noteriale të disa prej aksionarëve të shoqërisë mbi njohjen e plotësimit të kushteve për transferimin e aksioneve, referuar marrëveshjes kuadër të vitit 2010.

Konkretisht, aksionarët;

- Enkelejd Joti, zotërues i 3% të aksioneve, shoqëria "E&E INVESTMENT" sh.p.k, zotërues i 10.5% të aksioneve, , "DEM Capital" zotërues i 10.5% të aksioneve, Shoqëria "Union Distribucion Servis Albania" sh.p.k., zotërues i 10% të aksioneve, Eduard Poda,

zotërues i 2% të aksioneve, kanë transferuar një përqindje të aksioneve të tyre tek aksionarët: AIBA Kompani, Alba Gina, Agim Zeqo dhe Samir Mane.

Si rrjedhojë, shoqëria "A.I.B.A Kompani" sh.a., prej datës 31.12.2019, zotëron 3.68% të aksioneve në shoqërinë "Digit-Alb" sh.a., Z. Agim Zeqo, prej datës 31.12.2019, zotëron 1.32 % të aksioneve në shoqërinë "Digit-Alb" sh.a., Zj. Alba Gina, prej datës 31.12.2019, zotëron 1,03% të aksioneve në shoqërinë "Digit-Alb" sh.a. dhe Z. Samir Mane, prej datës 31.12.2019, zotëron 1.32% të kuotave në shoqërinë "Digit-Alb" sh.a.

Neni 74 i ligjit nr. 97/2013, "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, parashikon se: "2. *Transferimi i të drejtave dhe detyrimeve, që rrjedhin nga licenca, nuk mund të realizohet pa marrë parapakisht miratimin me shkrim të AMA-s*".

Në rastin konkret rezulton se, shoqëria "DIGIT-ALB" sh.a., nuk ka hyrë në marrëdhënie juridike civile, objekt i të cilave të jetë veprimtaria radiotelevizive e licencuar, por disa prej aksionarëve të shoqërisë kanë transferuar një përqindje të aksioneve tek aksionarët e rinj, që kanë njoftuar ndryshimet në strukturën e pronësisë. Transferimi i aksioneve është kryer në zbatim të një marrëveshjeje lidhur në vitin 2010.

Pas transferimit të aksioneve, përqindja e kuotave të pronësisë të aksionarëve që kanë transferuar përqindje aksionesh, paraqitet si më poshtë: Enkelejd Joti, me 2.52 % të aksioneve; Eduard Poda, me 1,52 % të aksioneve; Shoqëria "Union Distribucion Servis Albania" sh.p.k., me 6,8 % të aksioneve, Shoqëria "DEM Capital" sh.p.k., me 8,90% të aksioneve; Shoqëria "E&E INVESTMENT" sh.p.k., me 8,90 % të aksioneve; Shoqëria "UNION GRUP" sh.p.k., me 6,80 % të aksioneve;

Shoqëria "DIGIT-ALB" sh.a., rezulton se nuk ka detyrime financiare ndaj AMA-s dhe Buxhetit të Shtetit.

Sa më sipër, njoftimet e paraqitura janë të drejta dhe të mbështetura në ligj,

PËR KËTO ARSYE,

Autoriteti i Mediave Audiovizive, në mbështetje të nenit 19, pika 16 dhe nenit 74 të ligjit nr. 97/2013, "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar,

V E N D O S I:

1. Miratimin e ndryshimeve në strukturën e pronësisë së shoqërisë "DIGIT-ALB" sh.a., duke transferuar një përqindje të aksioneve të aksionarëve: Enkelejd Joti, (zotërues i 3% të aksioneve), shoqëria "E&E INVESTMENT" sh.p.k., (zotërues i 10.5% të aksioneve), "DEM Capital" (zotërues i 10.5% të aksioneve), shoqëria "Union Distribucion Servis Albania" sh.p.k., (zotërues i 10% të aksioneve), Eduard Poda, zotërues i 2% të aksioneve, tek aksionarët e rinj: Shoqëria "AIBA Kompani" sh.a. (zotërues i 3.68% të aksioneve, Alba Gina (zotërues i 1.03% të aksioneve), Agim Zeqo (zotërues i 1.32% të aksioneve) dhe Samir Mane (zotërues i 1.32% të aksioneve).
2. Struktura e pronësisë së shoqërisë "DIGIT-ALB" sh.a.: është: Agim Zeqo me 1.32% të aksioneve; Alban Jaho, me 3% të aksioneve; Itan Hoxha, me 10.19% të aksioneve; Samir Mane, me 1.32 % të aksioneve; Alba Gina, me 10.3% të aksioneve; Enkelejd Joti, me 2.52 % të aksioneve; Eduard Poda, me 1,52 % të aksioneve; Redia Hoxha, me 10.19% të aksioneve; Shoqëria "Union Distribucion Servis Albania" sh.p.k., me 6,8% të aksioneve, Shoqëria "DEM Capital" sh.p.k., me 8,90% të aksioneve; Arch Investor me 3,20% të aksioneve; shoqëria "A.I.B.A. kompani" sh.a., me 3,68% të aksioneve; shoqëria

“E&E INVESTMENT” sh.p.k., me 8,90 % të aksioneve; shoqëria “UNION GRUP” sh.p.k., me 6,80 % të aksioneve; shoqëria “LORESA” sh.p.k., 30,60% të aksioneve.

3. Ngarkohet administrata e AMA-s për kryerjen e veprimeve të mëtejshme në zbatim të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetar:	Gentian	SALA
Zëvendëskryetar:	Sami	NEZAJ
Anëtarë:	Agron	GJEKMARKAJ
	Gledis	GJIPALI
	Suela	MUSTA